



SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT



◆ **RAPORTI**
PUBLIK
2018

www.shish.gov.al

RAPORTI PUBLIK 2018 - KRYESORET



Parimet bazë të punës së SHISH-it:

Ligjshmëria

Objektiviteti

Fshehtësia

Veprimtaria e SHISH-it kontrollohet nga:

Parlamenti

Kryeministri (përmes Inspektorit të Përgjithshëm)

Prokurori i Përgjithshëm

Auditi i brendshëm

Kontrolle të autorizuara

Presidenti
Kryeministri
Kryetari i Kuvendit
Kryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare
Ministri e institucione



Kontrolle për Veting sipas viteve:





SHISH-i raporton dhe dërgon informacion te:

Buxheti i SHISH-it



Numri i produkteve informative sipas viteve:



PËRMBAJTJA

2	Paraqitje e shkurtër nga Drejtori i SHISH-it
4	Mbi Shërbimin Informativ të Shtetit
4	Historiku
8	Sistemi i Sigurisë në Republikën e Shqipërisë
14	Menaxhimi dhe kontrolli i SHISH-it
14	Struktura organizative
15	Burimet njerëzore
18	Buxheti 2018
19	Dorëzimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në Arkivin Shtetëror
20	Zhvillimi i kapaciteteve IT&T
21	Gjendja e Sigurisë në Republikën e Shqipërisë
21	Veprimtaria në fushën e kundërzbulimit
22	Terrorizmi
23	Krimi i organizuar, trafiku i lëndëve narkotike, korrupsioni dhe krimet në ekonomi
24	Siguria e informacionit
25	Gjendja politike dhe e sigurisë në rajon
25	Procedurat në veprimtarinë informativo-operative
26	Kontrolle pët veting
27	Produkti informativ i SHISH-it 20016-2018
28	Kontrolli i SHISH-it
29	Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit
30	Mite dhe fakte
31	Nisma sociale dhe humanitare
32	Një muze në SHISH
35	Përgjegshmëria para publikut
36	Lista e shkurtesave

Paraqitje e shkurtër nga Drejtori i SHISH-it

Në cilësinë e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin tonë të parë publik dhe t'ju flas shkurt mbi drejtimit kryesore të punës sonë dhe rolin e Shërbimit për mbrojtjen e sigurisë sonë kombëtare.

Unë besoj se, nxjerrja në dritë e këtij raporti të parë publik do të rritë ndërgjegjësimin e publikut dhe besimin e tij ndaj agjencisë sonë, ndaj veprimtarive që zhvillojmë, si dhe do të ketë ndikim pozitiv në sigurinë kombëtare.

Në përmbushjen e misionit të tij, SHISH-i mbledh, përpunon dhe shpërndan informacione për autoritetet e larta shtetërore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Në këtë raport të parë publik, kemi zgjedhur t'i paraqesim opinionit publik ato që i konsiderojmë si të nevojshme të njihen, pa hyrë në hollësi administrative apo operacionale.

Detyra jonë është mbledhja dhe transmetimi në kohë të informacionit, dhënia e vlerësimeve objektive dhe të paanshme, që vendimmarrësit politikë të marrin vendime të mirinformuara, duke shfrytëzuar analiza informative profesionale.

Besojmë se asetet më të çmuara për Shërbimin janë punonjësit e tij, që punojnë me përkushtim dhe sakrificë për të përmbushur objektivat. Kërkojmë më të mirën prej tyre, duke nxitur punën në ekip, cilësitë dhe standardet më të mira profesionale, besnikërinë ndaj Shërbimit dhe ndaj njëri-tjetrit.

Viti 2018 ka qenë tepër i suksesshëm për SHISH-in. Ndjem krenar të them se Shërbimi vazhdoi të ofronte informacione të vlefshme për vendimmarrësit dhe agjencitë ligzbatuese. Kontributi thelbësor i SHISH-it në përballjen me kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare është vlerësuar nga institucionet më të larta shtetërore dhe nga aleatët strategjikë.

Shërbimet dhe agjencitë e huaja të fshehta jomiqësore që zhvillojnë veprimtari kundër interesave kombëtare të Shqipërisë, terrorizmi ndërkombëtar, krimi i organizuar dhe korrupsioni mbeten kërcënimet kryesore ndaj Shqipërisë për periudhën që mbulon

ky raport i parë publik.

SHISH-i ka ndjekur dinamikën e zhvillimeve në rajon dhe ndikimin e tyre në rrafshin politik dhe të sigurisë. Kontributi i SHISH-it për sigurinë rajonale ka marrë vlerësime të larta nga drejtuesit politikë brenda vendit, nga partnerët strategjikë dhe nga strukturat e inteligjencës së NATO-s.

SHISH-i mbështet angazhimin e Kuvendit dhe të qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të zhvilluar këshillime mbi çështje të lidhura me sigurinë kombëtare, si dhe bashkëpunimin me strukturat e zbatimit të ligjit.

Shërbimi nxit edhe konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me shërbimet dhe agjencitë e huaja partnere, sidomos me ato strategjike dhe rajonale, me strukturat e NATO-s dhe BE-së, në përballimin e kërcënimeve të përbashkëta.

Të diskutosh publikisht për punën tonë nuk është e lehtë. Duhet ruajtur baraspesha mes përgjegjësisë së lartë, klasifikimit të veprimtarive dhe detyrimit për transparencë, mes sigurisë operacionale, përmirësimit të imazhit dhe hapjes me opinionin publik, për një ngritje cilësore dhe transparencë ndaj taksapaguesve.

Si Drejtor i SHISH-it, dëshiroj të siguroj publikun se jemi të angazhuar t'i kryejmë veprimtaritë tona me seriozitet dhe profesionalizëm, me respektin më të lartë për Kushtetutën dhe për të drejtat e liritë themelore të njeriut.

Punonjësit tanë janë çdo ditë të përkushtuar për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, në interes të gjithë shtetasve tanë. Ne i modernizojmë vazhdimisht metodat e punës, që të jemi sa më efikasë në këtë mjedis dinamik dhe të ndërlikuar të sigurisë.

Dua t'ju siguroj se, besimi i patundur dhe pritshmëritë e larta të drejtuesve tanë politikë dhe institucionalë, si dhe të partnerëve ndërkombëtarë, do të materializohen në rezultate cilësore dhe konkrete.

Faleminderit!

Helidon Bendo

Drejtor i Shërbimit Informativ të Shtetit



MBI SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT



HISTORIKU


Krijimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Vlorës 1912

Me fillimin e Luftës së Dytë Ballkanike, Mushtrinë e huaja të Aleancës Ballkanike kishin pushtuar pjesën më të madhe të vendit. Qeveria e sapoformuar përballë me shumë sfida të mëdha, që kishin të bënin me rrethanat shoqërore e politike të kohës, rënien e Perandorisë Osmane, Luftën Ballkanike, përcak-

timin e kufijve të shtetit të ri shqiptar, etj.

Në këto rrethana historike dhe në interes të ruajtjes së kufijve të shtetit të ri shqiptar, qeveria vendosi krijimin e ushtrisë kombëtare dhe të shërbimit sekret. Qeveria e sapoformuar dhe kryeministri Ismail Qemali vlerësuan rëndësinë e ngritjes së një strukture të fshehtë informative për të mbledhur informacion për gjendjen politike, ushtarake, morale dhe ekonomike në zonat e pushtuara, me synim

Vendimi i krijimit të Shërbimit të Fshehtë



17 dhjetor 1912

marrjen e vendimeve të sakta dhe orientimin e politikave të brendshme dhe të jashtme, për mbijetesën e shtetit të ri, në ato kohë kritike historike.

Shteti shqiptar nisi të kryejë aktivitete informative (të inteligjencës), që në ditët e para pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912. Në një nga vendimet e para të qeverisë Shqiptare, me kryeministër Ismail Qemalin, më 17 dhjetor 1912, thuhej: “Të organizohet një shërbim i msheftë për vise të shkeluna të Shqipërisë”. Realizimi i këtij misioni iu ngarkua Lef Nosit dhe Bajram Currit.

Qeveria i përcaktoi si detyrë shërbimit të sapoformuar mbledhjen e informacionit, me fokus të veçantë në zonat e pushtuara. Qëllimi i mbledhjes së informacionit ishte krijimi i një panorame sa më të plotë të gjendjes në terren, veprimet e ushtrive pushtuese, organizimi dhe mobilizimi i popullit për çlirimin e zonave të pushtuara dhe vendosja e autoritetit të shtetit në të gjithë territorin.

Shërbimi sekret shqiptar vijoi veprimtarinë e tij edhe pas ardhjes së princ Vilhelm Vidit, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe pas saj.

Konsolidimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Ahmet Zogut 1921-1939

Më 21 janar 1920, Kongresi Kombëtar i Lushnjës krijoi Këshillin e Naltë dhe risanksionoi ndarjen e pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe krijimin e Ministrisë së Brendshme. Më 24 dhjetor 1921, Ministër i Punëve të Brendshme u dekretua Ahmet Zogu, i cili riorganizoi MPB-në, duke krijuar Seksionin Sekret. Drejtues i këtij seksioni u caktua Haki Stërmilli. Shërbimi inteligjent



HAKI STËRMILLI

shqiptar, gjatë kësaj periudhe, mori formë dhe përmbajtje më institucionale. Ky shërbim ka mbajtur emërtesat Sekretari Sekrete dhe Zyrë Sekrete. Në nivel qendror, veprimtaria e shërbimit sekret drejtohej nga Zyra Sekrete, ndërsa në nivel vendor drejtohej nga Prefekti, i cili kishte ngritur një strukturë të posaçme për “çështje rezervate”.

Me konsolidimin e institucioneve të Shtetit Shqiptar, më 1927, pati rëndësi edhe organizimi i Shërbimit të Jashtëm, me qendër në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Shërbimi Informativ i Jashtëm e organizoi punën në misionet diplomatike jashtë shtetit, duke ngri-

tur një rrjet informativ që vepronte i lidhur me mekanizmin konsullatë-legatë-prefekturë. Klane dhe forca të ndryshme politike gjatë kësaj periudhe, të shtyrë nga interesa të caktuara politike, të përkrahura edhe nga jashtë, kanë provokuar trazira, komplete, vrasje, kryengritje, etj., me qëllim destabilizimin e vendit dhe cenimin e sigurisë kombëtare.

Vlen të theksohet se struktura dhe organizimi i shërbimeve sekrete shqiptare, në këtë periudhë historike, ndoqën modelet e shteteve të tjera, me traditë në fushën e inteligjencës, duke kryer veprime kundërzbulimi për të mbledhur informacion brenda vendit si dhe detyra zbulimi, duke mbledhur informacion jashtë vendit, në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet që cenonin sigurinë kombëtare.

Organet e Sigurimit të Shtetit 1944-1991

Pas Luftës së Dytë Botërore, në periudhën 1944-1945, shteti shqiptar i kushtoi menjëherë një rëndësi të veçantë krijimit të Organeve të Sigurimit të Shtetit. Këto ishin vijuese të Shërbimit Informativ Ushtarak, strukturë që ishte ngritur gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Fillimisht, në 1945-ën, u krijua Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, e cila përbëhej nga shërbimi sekret, policia dhe forcat e kufirit, të inkuadruara në Ministrinë e Mbrojtjes. Në 1946-ën, u krijua Drejtoria e Sigurimit të Shtetit. Me riorganizimin e vitit 1966, Sigurimi i Shtetit u riorganizua në tri drejtori: Drejtoria e Parë e

Kundërzbulimit, me njësi në Qendër dhe në bazë, duke u shtrirë në të gjithë territorin e vendit, Drejtoria e Dytë që quhej ndryshe Drejtoria e Udhëheqjes dhe kishte mision ruajtjen fizike dhe sigurinë e udhëheqjes së vendit, si dhe Drejtoria e Tretë, apo siç njihesh ndryshe, “zbulimi politik”, i cili kishte mision mbledhjen e informacionit jashtë vendit. Të gjitha këto njësi ishin të centralizuara dhe në varësi të Zëvendësmnistrit të Punëve të Brendshme.

Sigurimi i Shtetit ishte pjesë e Forcave të Ar-



matosura të Republikës së Shqipërisë.

Organet e Sigurimit të Shtetit ushtruan veprimtarinë e tyre bazuar në një platformë të ish-Byrosë Politike, të pambështetur në ligj. Prioritetet, objektivat, qëllimet dhe fusha e veprimtarisë vendoseshin nga lidershipi komunist. Si pasojë, kjo solli shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, shkelje ligjore, politizim të strukturave të inteligjencës në funksion të partisë-shtet.

Reformimi i Shërbimit Sekret shqiptar 1991 dhe në vazhdim

Pas vitit 1990, me vendosjen e pluralizmit politik në vendin tonë, organet e Sigurimit të Shtetit u reformuan, duke iu përshtatur kërkesave të shtetit ligjor. Qëllimi ishte reforma në shërbimet sekrete, me synim krijimin e një shërbimi jo-politik, profesional dhe në funksion të sigurisë kombëtare.

Kështu, në vitin 1991, u krijua SHIK-u (Shërbimi Informativ Kombëtar), me Ligjin Nr. 7495, datë 02.07.1991, "Për organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar". Misioni dhe detyrat ligjore të këtij Shërbimi ishin parandalimi, zbulimi dhe ndërprerja e çdo

veprimtarie antikushtetuese që cenon lirinë, pavarësinë, aftësinë mbrojtëse, tërësinë territoriale dhe pasurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. SHIK-u u krijua si një institucion i pavarur dhe, si i tillë, ka pësuar në vijimësi ndryshime organizative dhe strukturore.

Në vitin 1998, me Ligjin Nr. 8391, datë 28.10.1998, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë vendosi:

Neni 1: Shërbimi Informativ Kombëtar (SHIK) është organ informativ në funksion të sigurimit kombëtar, që vepron në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Me këtë ligj, SHIK-u transformohet, nga shërbim operativ-gjurmues, në shërbim informativ, pa kompetenca ekzekutive.

Në vitin 1999, me Vendimin Nr. 61, datë 22.11.1999, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ndryshohet emërtimi nga Shërbimi Informativ Kombëtar (SHIK) në Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH).

Reformimi i vazhdueshëm i shërbimeve sekrete shqiptare, pas viteve 1990-të, është bërë në bashkëpunim me shërbimet partnere strategjike, gjithnjë duke marrë dhe vënë në zbatim praktikatat më të mira në fushën e inteligjencës.

Emblema e Shërbimit Informativ të Shtetit

Emblema e SHISH-it është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit të Shqipërisë, Nr. 171, datë 03.08.2006, "Për miratimin dhe përdorimin e Emblemës së Shërbimit Informativ të Shtetit".

Emblema është kompozuar në gjininë e medaljonit, në formë klasike rrethore, me nivelet basoreliev dhe altoreliev. Ajo ka në përbërje shqiponjën dykrenare, marrë nga flamuri kombëtar, dhe simbolizon forcën, mençurinë dhe vizionin për të ardhmen. Elipsi i artë, i konceptuar si abstraksion formal në formë rrethore, përkon me ciklin informativ të planifikimit,

drejtimit, mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes, në mënyrë profesionale, të inteligjencës. Kristali në qendër të emblemës simbolizon mendimin e kthjellët dhe produktin përfundimtar të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Në pjesën fundore, shkurtesa SHISH mbështetet në një fragment kurore dafine, e cila mbart simbolin e trimërisë dhe lavdisë. Emblema është konceptuar në ngjyrë argjendi me elementët në ngjyrë ari. Qendra e emblemës, e cila është edhe sfond i të gjithë elementëve të saj, është me ngjyrë blu parizian të errët.



NGJARJET KRYESORE NË HISTORINË E SHËRBIMEVE SEKRETE

17.12.1912 Qeveria Shqiptare, me Kryeministër Ismail Qemalin, vendosi: Të organizohet një shërbim i msheftë, për vise të shkeluna të Shqipërisë.

24.12.1921 Ahmet Zogu dekretohet Ministër i Punëve të Brendshme. Riorganizohet MPB-ja, duke krijuar Seksionin Sekret. Haki Stërmilli caktohet drejtues i këtij Seksioni.

Janar 1927 Organizohet Shërbimi Informativ i Jashtëm, që shtrin veprimtarinë agjenturore dhe operative jashtë vendit, me koperturë misionet diplomatike jashtë shtetit.

02.07.1991 Miratohet Ligji nr.7495 "Për Organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar", krijohet SHIK-u.

22.11.1999 Me Vendimin Nr. 61 të Gjykatës Kushtetuese të R.SH. ndryshohet emërtimi nga Shërbim Informativ Kombëtar (SHIK) në Shërbim Informativ i Shtetit (SHISH).

21.01.1920 Kongresi Kombëtar i Lushnjës vendosi krijimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

1922-1939 Shërbimi Sekret ndërron emërtesën nga Sekretari Sekrete në Zyrë Sekrete; organizohet në nivel Qendror dhe Vendor.

1944-1991 Organizohen dhe ushtrojnë veprimtarinë Organet e Sigurimit të Shtetit. Në 1966, pësojnë ndryshime strukturore e varësie dhe riorganizohen në tri drejtori kryesore, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

28.10.1998 Me Ligjin Nr.8391, Kuvendi vendosi: Shërbimi Informativ Kombëtar është organ informativ në funksion të sigurimit kombëtar, që vepron në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

SISTEMI I SIGURISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Strukturat e Sigurisë Kombëtare

Strategjia e Sigurisë Kombëtare është dokumenti themelor planifikues për sigurinë kombëtare të RSH-së. Përgjegjësinë kryesore institucionale për zbatimin e SSK-së e ka Këshilli i Ministrave, institucionet në varësi të tij dhe ministratë e linjës.

Për plotësimin e detyrave të tij në fushën e sigurisë kombëtare, Kryeministri mbështetet nga Komiteti i Politikave të Sigurimit Kombëtar (KPSK). KPSK-ja është organ këshillimor i nivelit politik për Kryeministrin. Organizimi, përbërja dhe detyrat e KPSK-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kryeministri i paraqet Kuvendit të RSH-së dhe Presidentit të Republikës një raport të përvitshëm për gjendjen e sigurisë kombëtare dhe Direktivën Vjetore të Sigurisë së RSH.


Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillues i Presidentit. Ky Këshill ushtron veprimtarinë në bazë të Kushtetutës, të ligjeve

e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi. Këshilli i Sigurimit Kombëtar këshillon Presidentin e Republikës për çështje të sigurisë e mbrojtjes së vendit, si dhe të drejtimit, organizimit e mobilizimit të burimeve njerëzore dhe materiale në dobi të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Drejtori i SHISH-it është anëtar i Këshillit të Sigurimit Kombëtar, drejtuar nga Presidenti dhe i Komitetit të Politikave të Sigurisë Kombëtare, drejtuar nga Kryeministri. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit.

SHISH-i raporton dhe dërgon informacione:

- Presidenti i Republikës
- Kryeministri i Shqipërisë
- Kryetari i Kuvendit
- Kryetari i Komisionit të Sigurisë
- Ministri dhe institucione të tjera, sipas nevojave.



Roli i SHISH-it

SHISH-i ka mision themelor mbrojtjen e sigurisë kombëtare, ruajtjen e integritetit, të parvarësisë dhe rendit kushtetues.

Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) është institucion qendror informativ. Si i tillë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë e ngarkon me “një rol themelor parashikues, parandalues dhe goditës ndaj rreziqeve për sigurinë kombëtare”.

SHISH-i raporton te Kryeministri dhe Presidenti për probleme që lidhen me sigurinë kombëtare.


Veprimtaria e SHISH-it ka si udhërrëfyes Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Prioritetet Vjetore të përcaktuara nga Kryeministri i Shqipërisë.

SHISH-i bashkëpunon e shkëmben informacion me institucione të tjera shtetërore brenda dhe jashtë vendit, për përmbushjen e detyrave që i ngarkon ligji.

Baza Ligjore

Shërbimi Informativ i Shtetit e ushtron veprimtarinë e tij bazuar në:

- Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, ndryshuar me ligjin nr. 9885, datë 3.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 10 172, datë 22.10.2009, ndryshuar me ligjin nr. 116, datë 13.12.2012.
- Procedurat e hartuara nga Drejtori i SHISH-it dhe të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë.



Detyrat kryesore

SHISH-i kryen detyra zbulimi dhe kundërzbulimi në këto drejtime kryesore:

- Mbledh informacion nga jashtë, në funksion të sigurisë kombëtare.
- Kryen veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë dhe rendit kushtetues.
- Mbledh informacion për:
 - Terrorizmin.
 - Prodhimin dhe trafikun e narkotikëve.
 - Prodhimin e armëve të dëmtimit në masë.
 - Krimet kundër mjedisit.
 - Krimin e organizuar që cenon sigurinë kombëtare etj.



Fushat e veprimtarisë së SHISH-it

SHISH-i e zhvillon veprimtarinë operative-informative, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, në bazë të ligjit Nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar me ligjin Nr. 8479, datë 29.04.1999, dhe ka mi-

sion themelor mbrojtjen e sigurisë kombëtare, ruajtjen e integritetit, të pavarësisë dhe të rendit kushtetues të RSH-së.

Prioritetet vjetore të Qeverisë për SHISH-in, pasi miratohen nga Kryeministri, dërgohen nga Qeveria e RSH-së çdo fillim viti me qëllim orientimin dhe drejtimin e punës dhe veprimtarisë së Shërbimit gjatë vitit.

- Ligji i SHISH-it
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare
- Prioritetet Vjetore të Kryeministrit dhe Qeverisë për SHISH-in
- Plani Vjetor i Punës së SHISH-it
- Strategjitë Ndërinstitucionale

ZBULIM

1. Me “Zbulim” kuptohet mbledhja e informacionit në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet që drejtohen nga jashtë ndaj vendit tonë dhe cenojnë apo synojnë të cenojnë sigurinë kombëtare. Ato shfaqen në format e terrorizmit, përpjekjeve për përmbysjen e rendit kushtetues, cenimit të pavarësisë dhe integritetit të vendit, krimit të organizuar, trafikeve, përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, krimeve kundër mjedisit, etj.

KUNDËRZBULIM

2. Me “Kundërzbulim” kuptohet mbledhja e informacionit lidhur me kërcënimet e rreziqet që identifikohen brenda vendit tonë dhe cenojnë apo synojnë të cenojnë sigurinë kombëtare, që shfaqen në format e spiunazhit, veprimtarive terroriste, përpjekjeve për përmbysjen e rendit kushtetues, cenimit të pavarësisë e integritetit të vendit, krimit të organizuar, trafikeve, përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, prodhimit e trafikimit të narkotikëve, krimit kundër mjedisit, etj.



ANALIZË

3. Me “Analizë” kuptohet një proces i organizuar i vlerësimit, përpunimit dhe integritetit të të dhënave dhe informacionit nga zbulimi dhe kundërzbulimi, me qëllim përgatitjen e produktit informativ përfundimtar për instancat e larta shtetërore dhe agjencitë ligjzbatuese.



SHISH-i, për të siguruar informacionin e nevojshëm që lidhet me sigurinë kombëtare, përdor:

1. Burime Informativ Njerëzore
2. Burimet e Hapura
3. Burimet Teknologjike Informativ



DRITANI – Njësia e mbikëqyrjes fizike

Unë punoj në SHISH, në njësinë e mbikëqyrjes fizike. Puna ka të bëjë me vëzhgimin e personave me interes për SHISH-in, por pa u vënë re nga këta persona. Durimi dhe vetëpërmbajtja janë kushte themelore për të pasur sukses në këtë detyrë. Është një punë e veçantë, emocionuese dhe paparashikueshme, e cila kërkon aftësinë për t'u shkruar me mjedisin rrethues. Duhet të jesh i përgatitur për orë të gjata pritjeje apo për hedhje menjëherë në veprim. Duhet të dish të ruash qetësinë, të jesh i përqendruar dhe profesionist. Shpesh puna ime nuk ka orar të caktuar ndërsa puna në ekip është thelbësore për suksesin. Më motivon fakti që jap ndihmesën time për sigurinë e shoqërisë.



AGRONI – Inspektor çështjeje

Unë jam Agroni, inspektor çështjeje në Shërbimin Informativ të Shtetit. Puna ime është të mbledh informacione. Puna është komplekse, prandaj dhe mbledhja e informacioneve nuk është aq e thjeshtë. Duhet të kesh njohuri, durim dhe vëmendje ndaj hollësive. Si inspektor çështjeje, flas shpesh me njerëzit dhe dëgjoj historitë e tyre. Detyra kërkon të jem i përmbytur dhe pa paragjykitime, i hapur ndaj ideve dhe mendimeve të tjerëve. Kjo punë nuk ka orare fikse dhe detyrat kërkojnë elasticitet. Me informacionet e mbledhura, kolegët analistë vlerësojnë nëse ka rreziqe për sigurinë kombëtare. Puna ime ndihmon në ruajtjen e sigurisë për gjithë shoqërinë.



MENAXHIMI DHE KONTROLLI I SHISH-IT



STRUKTURA ORGANIZATIVE

Pavarësisht përparimeve teknologjike në çdo fushë të jetës, rëndësia e faktorit njerëzor për sukses në punë në agjencitë informative nuk ka rënë. Cilësia e punës së SHISH-it varet, në masë të madhe, nga aftësitë dhe njohuritë e punonjësve të tij. Natyra e punës së SHISH-it ka nevojë për specialitete dhe profile profesionale nga më të ndryshmet.

Jo vetëm për shkak të natyrës së punës, por edhe për shkak të rreziqeve të lidhura me këtë punë, SHISH-i është i detyruar të mbrojë identitetin e punonjësve të tij.


Struktura dhe organika e SHISH-it propozohen nga Drejtori i SHISH-it dhe miratohet nga Kryeministri. Djathtas gjendet një paraqitje e thjeshtuar e saj.

Gjatë vitit 2018, SHISH-i iu nënshtroi një ristrukturimi me qëllim ndjekjen e ritmeve

që diktojnë zhvillimet e kohës, modernizimin dhe përmbushjen e projekteve ambicioze, që do të rritin më tej cilësinë e punës operative dhe analitike.

Gratë përbëjnë mbi 25% të

forcës së punës në SHISH. Përqindja e grave në pozicione të larta ka ardhur në rritje, ndërkohë që SHISH-i do të vazhdojë të promovojë rolin e grave në sektorin e sigurisë dhe inteligjencës.



BURIMET NJERËZORE

Të punosh në Shërbimin Informativ të Shtetit, është përgjegjësi e madhe dhe, mbi të gjitha, sfidë “intelektuale”. Kërkohej që të vësh inteligjencën në shërbim të zgjidhjes së problemeve komplekse, duke thyer barrierat e brendshme, me qëllim kuptimin e realitetit gjithnjë në ndryshim në të cilin jetojmë.

Për të punuar në SHISH, kërkohen parametra të caktuara të karakterit dhe profesionalizmit, të cilat i bashkon pasioni për të zbuluar të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Për këtë arsye, të punësuarit në SHISH konsiderohen si pasuri e vyer, jo si ingranazhe të makinerisë.

Pranimi në SHISH

Punonjësit e rinj rekrutohen në bazë të nevojave për vendet e lira dhe në linjë me planet e punësimit. SHISH-i merr kërkesa dhe aplikime për punë gjatë gjithë vitit nga kandidatë privatë, por bashkëpunon edhe me institucione të tjera për të përmbushur nevojat e tij. Zakonisht një herë në vit hartohet edhe një plan për punësimin mbështetur në këto nevoja. Procedurat e pranimit në SHISH bazohen në ligjin nr.9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të SHISH”, i ndryshuar, si dhe aktet normative të brendshme, të miratuara nga Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit.

Pranimi me konkurrim të hapur në SHISH, bëhet nëpërmjet shpalljes së vendit të lirë të punës dhe botohet në dy gazeta kombëtare me tirazh të madh, të pakën 30 ditë para datës së konkursit. Pranimi kalon në fazat e shqyrtimit dhe të verifikimit paraprak të dokumentacionit, të testimit me shkrim dhe të intervistës me gojë. Aplikantët e interesuar për të filluar punë Aplikantët e interesuar për të filluar punë në SHISH, pas shpalljes në faqen zyrtare të Internetit të SHISH-it dhe në gazetë, duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë personale;
- b) CV (përfshirë adresën e saktë të banimit, si dhe numrin e telefonit);
- c) Fotokopje e letërnjoftimit;
- d) Certifikatë familjare;
- e) Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe e listës së notave;
- f) Raport mjeko-ligjor;
- g) Vërtetim nga Gjykata e rrethit përkatës;
- h) Vërtetim nga Prokuroria e rrethit përkatës;
- i) Vërtetim nga Zyra Përmbartimore e rrethit përkatës;
- j) Certifikatë për gjuhën e huaj nga Fakultetet e Gjuhëve të Huaja;
- k) Certifikatë për njohjen dhe përdorimin e kompjuterit, nëse ka;
- l) Certifikatë trajnimesh në sferat përkatëse, nëse ka;
- m) Vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm, nëse ka;
- n) Fotokopje të librezës së punës, nëse ka;
- o) Fotografi dokumentesh 6x4, copë 4;
- p) Fotografi 9x12, copë 2.



Paraqitje skematike e punësimeve të reja në vitin 2018



Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet me postë pranë Zyrës së informacionit të Shërbimit Informativ të Shtetit në Tiranë ose në drejtoritë në rrethe, brenda afatit të njoftuar.

Procedura e konkurrimit, kalon në disa faza. Së pari, bëhet përzgjedhja në bazë të dokumenteve, e cila konsiston në verifikimin nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpallje. Në fazën e dytë, zhvillohet testimi me shkrim. Më pas, zhvillohet intervista me gojë e kandidatëve të përzgjedhur në fazën e dytë. Në përfundim të testimit, Shërbimi i kërkon ap-

likantit fitues të paraqitet pranë SHISH-it për të plotësuar dhe nënshkruar formularët e Vetëdeklarimit / Aplikimit për punësim / Verifikimit të Kushtit të Sigurisë. Pasi shqyrtohet ky dokumentacion, aplikanti fitues njoftohet nga Njësia e Administrimit të Burimeve Njerëzore.

Aplikanti fitues, i cili përmbush kushtin e sigurisë, i nënshtrohet një kursi trajnimi bazë të inspektorit në SHISH. Pas përfundimit me sukses të këtij trajnimi, kursanti i SHISH-it, në ceremoninë e diplomimit, kryen aktin solemn të betimit, sipas formulës së miratuar.

BETIMI

“Betohem solemnisht se do t’i shërbej me përkushtim e ndershmëri Republikës së Shqipërisë për forcimin e sigurisë kombëtare, do të veproj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, do të kryej me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm, detyrat që do të më ngarkohen, do të ruaj sekretin dhe do të jem besnik ndaj Shërbimit Informativ të Shtetit në përmbushjen e misionit të tij. BETOHEM!”

Emërimi

Pas daljes së urdhrorit të emërimit nga Drejtori i SHISH-it, në njësinë ku e dikton interesi i punës, punonjësi i emëruar fiton statusin e punonjësit të SHISH-it, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të SHISH-it”, i ndryshuar.

Punonjësi i SHISH-it duhet të plotësojë pranë njësisë së administrimit të burimeve njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratë “Për ruajtjen e informacionit të klasifikuar” në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

- Deklaratë “Për departizimin” në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të SHISH”, i ndry-

shuar, si dhe nenit 11 të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar.

- Autorizim në zbatim të nenit 10/2 dhe nenit 41/2 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

- Formular “Për vetdeklarimin/dekriminalizimin”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Punonjësi i nënshtrohet një periudhe prove prej një viti nga data e emërimit, nën kujdesin e një Mentori në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 9357, datë 17.03.2005, “Për statusin e punonjësit të SHISH-it”, i ndryshuar.

Edukimi dhe trajnimi

Edukimi dhe trajnimi i punonjësve është një përparësi e rëndësishme për SHISH-in. Këto programe zbatohen brenda SHISH-it, por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera akademike apo ente shtetërore. Ekzistojnë edhe programe trajnimi që zhvillohen jashtë vendit, gjithnjë në përputhje me fushën e veprimtarisë së SHISH-it.

Aftësia për të kuptuar thelbin e inteligjencës, është fryt i përvojës dhe rritjes së vazhdueshme profesionale. Është e nevojshme t’u qëndrosh besnik fakteve e jo interpretimit të tyre, sepse informacionet e dhëna mund të ndikojnë mbi zgjedhjet e një vendim-marrësi politik.

Prandaj, SHISH-i i kushton një vëmend-

je të veçantë trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të punonjësve të tij.

Në marrëdhëniet me universitetet, SHISH-i ka vendosur si objektivi thithjen e energjive të reja, të kualifikuara dhe të virtytshme, të përgatitura dhe të ndërgjegjësuar, për t’u bërë pjesë e komunitetit tonë. Për t’u përballur me sfidat e kohës, nevojitet bashkëpunim dhe ndërtimi i një aleance strategjike midis komunitetit të inteligjencës dhe botës akademike.

Punonjësit e SHISH-it trajtohen me pagë në zbatim të VKM-së nr. 432, datë 13.07.2007, i ndryshuar.

Për të mësuar më tepër mbi detyrimet dhe të drejtat e punonjësve të SHISH-it, mund të vizitoni faqen zyrtare: www.shish.gov.al



Buxheti faktik i Shërbimit Informativ të Shtetit për vitin 2017, ka qenë rreth 1,477 milion lek. Kjo vlerë është afërsisht 238.8 milion lek më shumë se në vitin 2013, ndërsa për vitin 2018 buxheti ishte rreth 1,548 milion lek ose 71.1 milion më shumë se realizimi i vitit 2017.

Trendet e realizimit buxhetor nga viti 2013 deri në 2018 jepen në grafikun më poshtë. Siç shihet nga grafiku, trendi buxhetor është në

të sigurisë kërkon detyrimisht mbrojtjen e të gjitha fushave të punës. Buxheti është një segment i totalit të gjithë këtyre veprimtarive dhe ka nevojë të mbrohet, meqë elementët përbërës të tij (financa, prokurimet, etj.) mund të ekspozojnë mjetet, pajisjet e prokuruar apo furnitorët, duke ndikuar negativisht në realizimin e objektivave.

Realizimi i investimeve nga viti 2013 deri në vitin 2018 paraqitet në grafikun më poshtë.



rritje, duke përballuar kërkesat më të mëdha për fonde, si përgjigje ndaj veprimtarive më të sofistikuara që cenojnë sigurinë kombëtare.

Në çdo vit, pjesën më të madhe të buxhetit të SHISH-it e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime për personelin, me trend uljeje 1% çdo vit.

Të dhënat mbi operacionet materiale dhe financiare të SHISH-it janë konfidenciale. Ndjeshmëria e veprimtarisë informative dhe

Siç shihet nga tabela, trendi i rritjes së shpenzimeve për investime është i dukshëm deri në vitin 2015, ndërsa duke filluar nga realizimi i vitit 2017 deri në vitin 2021 (planifikimi), investimet qëndrojnë pothuajse në të njëjtin nivel.

Shpenzimet faktike në këto vite janë fokusuar për blerje pajisjesh të teknologjisë së informacionit, me qëllim modernizimin e tyre, pajisje për tekniken operative dhe blerje automjetesh.

DORËZIMI I DOKUMENTEVE TË ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT NË ARKIVIN SHTETËROR

Në korrik 2017, SHISH-i dorëzoi tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), të gjithë fondin arkivor që i përkiste periudhës nga 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991, pavarësisht nga data e grumbullimit të tyre në arkiv.

Në këtë fond arkivor përfshihen dosje personash apo çështjesh, dosje të rëndësisë së veçantë, dosje agjenturore, dosje të tjera operative, fashikuj të ndryshëm, regjistra, procesverbale, statistika, kartela, libra, studime, tema, etj.

SHISH-i ka kryer një punë voluminoze për kategorizimin e këtyre materialeve. Përmasa e këtyre përpjekjeve ilustron nga fakti se janë dorëzuar mbi 100 dosarë, mbi 52 000 dosje dhe mbi 5 400 fashikuj. Çdo dosar ka dosje



më vete dhe çdo dosje është e ndarë në volume.

Ky dorëzim është kryer në zbatim të:

- Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 15.2.2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrim të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-

Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”;

- Urdhrit të përbashkët mbi dorëzimin e dokumentacionit të Ish-Sigurimit të Shtetit, (qershor 2017) ndërmjet SHISH-it dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Dorëzimi është pjesë e përpjekjeve të SHISH-it për ta bërë këtë material arkivor të vlefshëm edhe për studiuesit apo për publikun, me qëllim njohjen sa më mirë të kësaj periudhe historike.

Konsultimi me këto materiale bëhet sipas rregullave të caktuara për materialet e klasifikuara dhe për përdorimin e të dhënave personale.





ZHVILLIMI I KAPACITETEVE IT&T

Evoluimi i shpejtë i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimit (IT&T) dhe i shfrytëzimit të hapësirës kibernetike në përgjithësi, sjell në mënyrë të pashmangshme nevojën për qasjen sa më të shpejtë të çdo institucioni apo organizate në shfrytëzimin e mundësive të jashtëzakonshme që ofrojnë këto sisteme. Për të realizuar këtë detyrë, çdo organizatë ka nevojë të zhvillojë kapacitete në këtë fushë. Zhvillimi i kapaciteteve në IT&T ndahet kryesisht në dy shtylla kryesore:

1. Zhvillimi i kapaciteteve infrastrukture, në kuptim të përshtatjes, implementimit, integritetit dhe përditësimit të teknologjive në përdorim me platforma dhe sisteme bashkëkohore.

2. Zhvillimi i kapaciteteve në pikëpamje të burimeve njerëzore, si aspekti më i rëndësishëm në ndërtimin e një kuadri IT&T të plotë dhe të qëndrueshëm.

Gjate viteve të fundit, SHISH-i ka hedhur hapa cilësorë në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës IT&T, duke arritur në qasje bashkëkohore të infrastrukturave IT&T dhe duke aplikuar me sukses praktikatat më të mira në këtë

fushë. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë i kushtohet sigurisë së këtyre infrastrukturave, nëpërmjet metodave dhe teknologjive bashkëkohore në mbrojtjen e perimetrave dhe parandalimin e çdo situatë katastrofike të shkaktuar nga pakujdesia apo sulmet kibernetike.

Po kështu, një rëndësi e veçantë i kushtohet zhvillimit të burimeve njerëzore, me qëllim përshtatjen në kohë dhe cilësi me çdo ndryshim teknologjik, përmirësimin e teknologjive ekzistuese si dhe në reduktimin e kostove të konsulencës për qëllime të zhvillimit të infrastrukturës IT&T dhe mbrojtjes së saj.

Zhvillimet *in-house*, përdorimi/modifikimi gjithnjë e më i madh i softuereve me burim të hapur si dhe zbatimi rigoroz i politikave dhe procedurave të sigurisë në lidhje me infrastrukturën IT&T, jep mundësinë e një zhvillimi të vazhdueshëm teknologjik, duke kërkuar investime minimale dhe duke ofruar rrezik minimal. Për këtë arsye, ekipit IT&T në SHISH i kërkohet zhvillim profesional i vazhdueshëm në mënyrë që të jenë të përditësuar me risitë teknologjike dhe aplikimin e këtyre teknologjive në institucion, sipas parimit AMARP (*as much as reasonably practicable*).




ALMA – Specialiste IT

Jam diplomuar në teknologji informacioni dhe kisha pesë vjet përvojë pune në këtë fushë. Dëshiroja të zhvillohesha më tepër nga ana profesionale, ndaj aplikova pranë Shërbimit Informativ për një vend pune në fushën time. Më thirrën shumë shpejt për intervistë dhe, pas bisedës dhe një kontrolli sipas rregullave, m'u ofrua një vend pune i përshtatshëm. Punësimi në SHISH më dha mundësi të zhvilloj më tej aftësitë dhe njohuritë profesionale. Natyra e veçantë e punës më motivon dhe ndjehem mirë që kam mundësi të jem pjesë e projekteve sfiduese së bashku me kolegët.



GJENDJA E SIGURISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË



VEPRIMTARIA NË FUSHËN E KUNDËRZBULIMIT

Monitorimi i veprimtarive dhe operacioneve të agjencive jomike informative apo të sigurisë, është prioritet madhor për SHISH-in. Shqipëria është vend objektiv për arsye politike, ekonomike dhe gjeostrategjike. Me anëtarësimin e vendit tonë në NATO dhe intensifikimin e përpjekjeve për integrim në BE, janë shtuar arsyet pse vendi ynë është objektiv me interes në rritje. Përveç ruajtjes së informacionit të klasifikuar kombëtar, Shqipëria ka për detyrë edhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare.

SHISH-i vlerëson se, një aktiviteti i shërbimeve informative jomike është i vijueshëm, i qëndrueshëm në kohë, me prirje rritjeje dhe me ndërthurje të metodave klasike me ato hi-

bride. Interes i tyre mbetet sigurimi i informacioneve mbi zhvillimet e brendshme dhe të jashtme, në raport me proceset integruese euroatlantike, me dinamikën në marrëdhëniet dypalëshe apo rajonale, informacioni konfidencial dhe i klasifikuar, etj. Ato synojnë të pengojnë përpjekjet për integrimin euroatlantik, të dëmtojnë kohezionin mes aleatëve dhe të rrisin ndjeshmërinë e një audience specifike në përputhje me synimet për paraqitjen e aleancës euroatlantike si një faktor kërcënues ushtarak. Vërehen prirje për grumbullim informacioni të klasifikuar, aktivitete influencuese, përdorim të hapësirës kibernetike, propagandës online, dezinformim, në favor të synimeve të tyre strategjike.

SHISH-i punon në mënyrë të vazhdueshme

për t'i monitoruar veprimtaritë e tilla, duke përdorur metodat e punës së kundërzbulimit, nëpërmjet verifikimit dhe rritjes së

ndërgjegjësimit të individëve dhe zyrtarëve që kanë qasje ndaj informacionit të klasifikuar.

TERRORIZMI

Terrorizmi është një kërcënim global dhe lufta ndaj tij është përparësi shumë e rëndësishme për SHISH-in. Ne vlerësojmë se ISIS/DAESH, Al-Kaeda dhe degët apo grupimet e lidhura me to janë mes grupeve terroriste që paraqesin kërcënim potencial për vendin tonë, rajonin e më gjerë.

SHISH-i bashkëpunon ngushtë me institucionet shtetërore, agjencitë ligjzbatuese dhe shërbimet partnere, në kuadër të monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive terroriste brenda dhe jashtë vendit. SHISH-i është i fokusuar edhe në monitorimin e përpjekjeve për indoktrinim, radikalizim e rekrutim të shtetasve shqiptarë në këto organizata.

Pas trysnisë ushtarake, humbjes së Kalifatit të vetëshpallur fizik, reduktimit të financave dhe burimeve njerëzore, ISIS/DAESH ka filluar tashmë zbatimin e strategjisë së shndërrimit në një lëvizje klandestine, e cila vijon të përbëjë kërcënim për sigurinë ndërkombëtare.

SHISH-i vlerëson se kthime masive të luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) nuk janë të pritshme në terma afatshkurtër. Një pjesë e tyre, mund të tentojë të kthehet në vendet e origjinës ose në vende të treta, nëpërmjet rrjeteve të trafikut njerëzor dhe krimit të organizuar. Më gjasë, organizata do të tentojë të ringrihet në rajone me vakum sigurie.

Kërcënimi terrorist në rajon dhe në vendin tonë

Vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor u përdorën, në fillimet e konfliktit në Siri, si rajone për rekrutime, çka solli një numër të lartë LHT nga rajoni. ISIS/DAESH dhe Al-Kaeda e kanë shënjestruar në vijimësi rajonin nëpërmjet propagandës, thirrjeve e nxitjeve për akte terroriste. Aktualisht, gjendja paraqitet e përmirësuar, vendet e rajonit kanë përforcuar masat kundër terrorizmit, kanë vënë në zbatim strategji efektive e reforma ligjore në luftën kundër terrorizmit si dhe kanë forcuar bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar.

Niveli i kërcënimit për akte terroriste në rajon vijon të vlerësohet i ulët, por me prirje në rritje, sidomos në prag të ngjarjeve simbolike. Deri tani, në rajon nuk ka pasur akte terroriste të bashkërenduara me pasojë viktima, por nuk kanë munguar nxitjet, organizimet për të tilla, të cilat kanë gjetur terren të përshtatshëm në individë të radikalizuar, të gatshëm për t'iu përgjigjur thirrjeve të tyre. Synimet dhe planet për akte terrori janë identifikuar dhe neutralizuar në fazë të hershme.

Udhëtimet e LHT nga Shqipëria drejt organizatave terroriste, pas vitit 2015 e në vijim,

janë ulur ndjeshëm e po shkojnë drejt ndërprerjes. Numri i të raportuarve të vrarë është rritur: 21% e numrit total. Rreth një e treta e tyre janë kthyer tashmë, kryesisht para adresimeve ligjore. Në terma të përgjithshëm, të kthyerit në rajon kanë ruajtur profil të ulët por, shumë prej LHT të kthyer në vendet e origjinës kanë gjetur të njëjtat kushte jetese, çka ka ndikuar në radikalizimin e mëtejshëm të tyre dhe vijimin e veprimtarive ekstremiste apo bërjen pjesë të kompleteve të zbulura terroriste.

Vlerësojmë se, mundësia që vendi ynë dhe rajoni të përdoren si vend tranzit për luftëtarët e huaj apo operativët terroristë drejt vendeve evropiane është në nivel të ulët, për shkak të forcimit të menaxhimit të kufijve dhe bashkëpunimit dypalësh, rajonal apo ndërkombëtar me shërbimet partnere strategjike. Rreziku dhe sfidat nga kjo kategori mbeten konstante, për shkak të vështirësive në identifikimin e tyre, të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara apo nga mundësia e kalimeve të jashtëligjshme nga rrjete e individë të përfshirë në trafikun njerëzor.

Kundërvënia

Dënimet e LHT, ndryshimet në legjislacion, për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, kanë qenë efektive në uljen e radikalizmit dhe rekrutimit në vend dhe në gjithë rajonin. Vendet e rajonit i janë bashkuar Koalicionit Global Kundër ISIS/DAESH, kanë zhvilluar një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për të kriminalizuar aktivitetet e lidhura me terrorizmin dhe janë duke zbatuar në mënyrë aktive Rezolutën 2178 të KS të OKB-së.

Është rritur në mënyrë domethënëse shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi dypalësh, rajonal e shumëpalësh. Janë realizuar disa aksione policore për arrestimin e personave të dyshuar për veprimtari që lidhen me terrorizmin. Është bërë e mundur identifikimi dhe kapja e personave në kërkim ndërkombëtar për çështje të terrorizmit.

Synimi i vazhdueshëm i SHISH-it është vlerësimi i kërcënimeve terroriste në terma afatshkurtra, afatmesme e afatgjata, si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera. Me

këtë synim, SHISH-i ka forcuar më tej bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, Prokurorinë, AISM-në dhe agjenci të tjera ligjzbatuese. SHISH-i ka dhënë dhe jep një kontribut të vlerësuar edhe për Aleancën e Atlantikut të Veriut në luftën kundër terrorizmit.

Për trajtimin e shkaqeve të radikalizimit që nxit ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, Qeveria e RSH-së ka hartuar dhe po zbaton “Strategjinë kundër ekstremizmit të dhunshëm”, me qëllim angazhimin e të gjithë shoqërisë në trajtimin e kësaj dukurie.

SHISH-i monitoron gjithashtu edhe individë dhe grupe të përfshirë në veprimtari ekstremiste, nacionaliste apo shoviniste, për aq kohë sa ata kryejnë veprimtari të tilla dhe shkëlin Kushtetutën e ligjet e RSH-së, bëjnë thirrje për dhunë mbi motive ideologjike, fetare, politike, raciale apo kombëtare.

SHISH-i është i fokusuar edhe në monitorimin e organizatave të ngjashme në rajon, të cilat, me veprimtarinë e tyre, përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare dhe atë rajonale.

KRIMI I ORGANIZUAR, TRAFIKU I LËNDËVE NARKOTIKE, KORRUPSIONI DHE KRIMET NË EKONOMI

Lufta kundër krimit të organizuar, organizatave, grupeve dhe individëve të përfshirë në aktivitetet të krimit të organizuar në përgjithësi, dhe atyre në fushën e kultivimit, prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike në veçanti, si përparësi kryesore e qeverisë dhe agjencive ligjzbatuese. Si e tillë, ajo përbën një nga fokuset kryesore dhe është objekt i punës së SHISH-it, për shkak të ndikimit negativ në zhvillimin ekonomik, pasojave sociale dhe cenimit të sigurisë kombëtare. Shërbimi ynë bashkëpunon ngushtë në këtë drejtim edhe me shërbimet inteligjente partnere.

SHISH-i vlerëson se, struktura të tilla kriminale janë agresive, kanë prirje për zgjerim dhe përshtatshmëri, për të shmangur masat e shtuara të agjencive të zbatimit të ligjit, përdorim të teknologjisë, komunikimeve të koduara, dokumenteve të falsifikuara, identiteteve të ndryshme, etj. SHISH-i përfaqësohet në Task Forcën Qendrore Ndërin-

stitucionale “Forca e Ligjit”, e ngritur për goditjen e grupeve kriminale që veprojnë në vendin tonë.

Falë kontributit të SHISH-it në TFQ “Forca e Ligjit”, janë realizuar operacione, të cilat kanë arritur ndërprerjen e veprimtarisë anti-ligjore që kryenin këto grupe kriminale. Goditja dhe ndjekja e kësaj veprimtarie kriminale është shoqëruar edhe me fokus të evidentimit dhe sekuestrimit të pasurive e parave të gjenerura nga kjo veprimtari kriminale.

SHISH-i gjithashtu mbledh informacion mbi trafikimin dhe tregtinë e paligjshme të armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, si dhe mbi veprimtaritë e individëve dhe organizatave të përfshira në prodhimin, trafikimin apo përdorimin e tyre për qëllime kriminale dhe terroriste. Emigracioni i paligjshëm dhe trafiku i qenieve njerëzore janë, po ashtu, objekt i veprimtarisë së SHISH-it.

SHISH-i mbledh informacion, bashkë-

punon ngushtë dhe mbështet organet përgjegjëse shtetërore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit në drejtimin kundër korrupsionit dhe krimeve në ekonomi. Veprimtaria e SHISH-it në këto fusha është e përqendruar në dukuritë e korrupsionit në nivele të

larta në sistemin e drejtësisë dhe administratën publike, në evazionin fiskal në përmasa të mëdha dhe me pasoja të rënda për ekonominë e vendit, në veprimtarinë e grupeve dhe organizatave të përfshira në pastrimin e parave dhe produktit kriminal, etj.

SIGURIA E INFORMACIONIT

SHISH-i, ashtu si edhe institucione të tjera shtetërore, ka qasje, administron dhe transmeton informacion të klasifikuar në rrjete të klasifikuara, të cilat mund të jenë objekt pune i shërbimeve të caktuara informative, i grupeve kriminale e terroriste, grupeve të kimit të organizuar, etj. Kërcënimet dhe sulmet kibernetike ndaj sistemeve të informacionit po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe kërkojnë një përgjigje profesionale dhe në kohë, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, rritjes së bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe trajnimit të vazhdueshëm të specialistëve të fushës.

Zhvillimet aktuale të teknologjisë dhe komunikimit digjital shfrytëzohen nga aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë për të kryer sulme kibernetike, spiunazh kibernetik, për të grumbulluar inteligjencë në fushën politike, ekonomike, ushtarake e teknologjike, për të forcuar propagandën, për të dërguar mesazhe të mbështetës të tyre, për të bashkërenduar veprimtarinë dhe për të mundësuar operacione terroriste në terren.

Në bashkëpunim me DSIK-në dhe institucione të tjera shtetërore, SHISH-i kontribuon në:

- Sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar, nëpërmjet zbatimit të një tërësie masash fizike, teknike, elektronike dhe procedurale për ruajtjen e zonave, ndërtesave, zyrave, dhomave dhe pajisjeve ku administrohet dhe transmetohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, kombëtar, i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Masat e sigurimit fizik kanë për qëllim mbrojtjen e informacionit të kla-

sifikuar “Sekret shtetëror”, kombëtar, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, nga veprimtaria e shërbimeve të huaja të vendeve jomiqësore, sulmet terroriste, vjedhja, dëmtimi, komprometimi, humbja, shkatërrimi, njohja nga persona të paautorizuar, të pacertifikuar, si dhe nga qasja e personave të paautorizuar në një nivel të caktuar informacioni të klasifikuar.

- Sigurimin elektronik, me qëllim parandalimin e ndërhyrjes, nga persona të paautorizuar, në zonat e sigurisë dhe mjediset ku punohet me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, kombëtar, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, si dhe vendosjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurimit elektronik, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e veprimtarive që synojnë të cenojnë sigurinë e informacionit të klasifikuar.

- Zhvillimi i teknologjisë ka mundësuar administrimin e informacionit të klasifikuar në sisteme informatike dhe transmetimin e tij të sigurt, nëpërmjet rrjeteve të klasifikuara dhe të certifikuara. SHISH-i e siguron informacionin e klasifikuar që administron dhe e transmeton nëpërmjet rrjeteve të tij të klasifikuara.

- Vetingun e personave të cilët kanë qasje dhe administrojnë apo transmetojnë informacion të klasifikuar në ente publike e jopublike.

- Monitorimin dhe informimin në kohë për kërcënimet kibernetike dhe për grupe, individë apo organizata që përdorin hapësirën kibernetike për veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare.



GJENDJA POLITIKE DHE E SIGURISË NË RAJON



VEPRIMTARIA NË FUSHËN E ZBULIMIT

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë përgjithësisht interesa gjeopolitike të përbashkëta dhe kanë ndërmarrë një sërë reformash për ndërtimin e shoqërive demokratike, ekonomisë së tregut, sundimit të ligjit dhe përmbushjen e standardeve të integritetit në strukturat euro-atlantike. Zëvendësimi përfundimtar i dinamikës së vjetër të shpërbërjes me dinamikën e re të integritetit euro-atlantike mbetet një nga sfidat më të vështira për ndërtimin e një rajoni të sigurt e të integruar.

Pavarësisht përpjekjeve për të gjetur zgjidhje në drejtim të problemeve të mbartura ndër vite, në marrëdhëniet dy e shumëpalëshe, ka probleme të cilat kanë cenuar stabilitetin dhe janë bërë pengesë në procesin e anëtarësimit në strukturat euroatlantike. Janë evidentuar kundërshtitë nga aktorë të veçantë rajonale, të

cilët kërkojnë të ruajnë statusin kuonë aktualë. Kjo, për shkak të interesave të ngushta politike që frymëzohen apo nxiten nga organizime me baza etnike e nacionaliste apo nga aktorë të tretë, në funksion të çuarjes përpara të interesave të tyre gjeostrategjike dhe paraqitjes së alternativave të tjera, në raport me integritetin euroatlantik.

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë e shteteve të tjera të rajonit në NATO dhe procesi i integritetit në BE ka rritur premisat për më shumë siguri dhe stabilitet brenda vendit dhe në rajon.

SHISH-i monitoron me kujdes dhe në vijimësi zhvillimet e rëndësishme politike dhe të sigurisë, të cilat mund të kenë ndikim në sigurinë kombëtare, në stabilitetin dhe sigurinë rajonale.

PROCEDURAT NË VEPRIMTARINË INFORMATIVO-OPERATIVE

SHISH-i është agjenci informative, nuk ka kompetenca ekzekutive dhe nuk kryen veprimtari të karakterit ushtarak apo policor. SHISH-i ka të drejtë ligjore të mbledhë informacion, duke përdorur procedurat e miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm.

1. SHISH-i mblodh informacion nga burime informative njerëzore brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Për të mbledhur informacionin e nevoj-

shëm, në funksion të sigurisë kombëtare, SHISH-i përdor teknika të Kontrollit fizik, Kontrollit elektronik, Kontrollit postar dhe Përgjimit e regjistrimit të telekomunikimeve.

Për realizimin e procedurave të mësipërme, SHISH-i udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë dhe objektivitetit, si dhe ruan raporte të drejta ndërmjet nevojës së sigurimit të informacionit të domosdoshëm dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Përgjimi i komunikimeve elektronike

Përgjimi i komunikimeve elektronike mbështetet në ligjin nr. 9157, datë 4. 12. 2003 (ndryshuar me ligjin nr. 9885, datë 3. 3. 2008, me ligjin nr. 10 172, datë 22. 10. 2009, ndryshuar me ligjin nr. 116, datë 13. 12. 2012, ndryshuar me ligjin 60/2017, datë 27. 4. 2017).

1. Ligji përcakton procedurat që ndiqen për përgjimin e komunikimeve elektronike nga institucione shtetërore informative të krijuara me ligj për realizimin e detyrave të tyre, si dhe procedurat që ndiqen nga personat e ngarkuar për përgjim.

2. Parimet bazë për përgjimin e komunikimeve elektronike janë respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nevojshmëria dhe proporcionaliteti, sekreti dhe objektiviteti në kryerjen e tij.

3. Asnjë institucion publik, të cilit i lejon ligji përgjimin e komunikimeve, nuk mund të paraqesë kërkesa të tilla për çështje apo veprimtari të papërcaktuara nga ligji si fusha të

detyrave apo veprimtarisë së tyre gjurmuese.

4. Miratimi/refuzimi i kërkesës për përgjimin e komunikimeve elektronike kryhet nga Prokurori i Përgjithshëm, ose prokurori i autorizuar prej tij.

5. Me krijimin e Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, kërkesa për përgjim depozitohet pranë Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

6. Dhënia e së drejtës për përgjim, pas shqyrtimit të kërkesës me shkrim, miratohet ose refuzohet nga Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose nga zëvendëskryetari i saj.

7. Asnjë qytetar në Republikën e Shqipërisë nuk mund të jetë objekt përgjimi/interceptimi i komunikimeve elektronike, pa miratim nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Gjykatës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

KONTROLLE PËR VETING


Vetingu është një veprimtari parandaluese, e cila identifikon probleme të mundshme sigurie për persona fizike e juridikë. Vetingu, si procedurë që synon forcimin e sigurisë së organizatave, parandalon individë të caktuar të kenë qasje në të dhënat e ndjeshme apo në pozicione të tilla ku mund të minojnë sigurinë dhe interesat e Republikës së Shqipërisë.

Procedura kryhet nga agjenci të autorizuar informative dhe të sigurisë, mes tyre edhe Shërbimi Informativ i Shtetit. Vetingu i sigurisë është strukturuar sipas standardeve të NATO-s dhe BE-së. Për shkak se vetingu përfshin qasje në të dhënat personale, është

përcaktuar një procedurë transparente e rregulluar sipas ligjeve të posaçme.

Në vitin 2018, pranë SHISH-it janë paraqitur gjithsej 5015 kërkesa vetingu për pajisjen me Certifikatë të Sigurimit të Personelit të personave të ndryshëm, (certifikatë që lejon njohjen e personave në fjalë me informacion të klasifikuar sekret shtetëror në nivele të ndryshme), kërkesa këto të ardhura nga një varg institucionesh. Mbështetur në informacionet e mbledhura, SHISH-i ka hartuar 3588 praktika dhe, në disa raste, ka kthyer përgjigje negative për vitin 2018.

Grafiku paraqet në shifra këtë veprimtari për 4 vitet e fundit.



2015

Janë hartuar 1704 praktika me rreth 3130 persona aplikues për paisje me Certifikatë Sigurimi të Personelit (CSP).

2016

Janë hartuar 1466 praktika me afërsisht 4900 persona aplikues për paisje me CSP.

2017

Janë hartuar 3308 praktika për 4898 persona aplikues për paisje me CSP.

2018

Janë hartuar 3588 praktika me rreth 5015 persona aplikues për paisje me CSP.

PRODUKTI INFORMATIV I SHISH-IT PËR PERIUDHËN 2016-2018

Për 2016-ën, SHISH-i ka prodhuar në total 2944 informacione për klientët brenda e jashtë vendit.

Për klientët brenda vendit, produkti informativ i SHISH-it ka shërbyer për informimin e institucioneve të larta të shtetit me:

- 378 informacione për Presidentin e Republikës, Kryeministrin e Shqipërisë dhe Kryetarin e Kuvendit.

- 289 informacione për ministrinë e linjës.

- 826 me destinacion Agjencitë e hetimit dhe të zbatimit të ligjit.

Për 2017-ën, SHISH-i ka prodhuar në total 3146 informacione për klientët brenda e jashtë vendit.


Për klientët brenda vendit, produkti informativ i SHISH-it ka shërbyer për informimin e institucioneve të larta të shtetit me:

- 267 informacione për Presidentin e Republikës,


Kryeministrin e Shqipërisë dhe Kryetarin e Kuvendit.

- 274 informacione për ministrinë e linjës.

- 1060 me destinacion Agjencitë e hetimit dhe të zbatimit të ligjit.



Përqindja e produktit informativ të shpërndarë në 2018, për klientët brenda vendit



Grafiku i prirjes së shpërndarjes së produktit informativ për klientët e brendshëm

Për 2018-ën, SHISH-i ka prodhuar në total 3601 informacione për klientët brenda e jashtë vendit.

Për klientët brenda vendit, produkti informativ i SHISH-it ka shërbyer për informimin e institucioneve të larta të shtetit me:

- 521 informacione për Presidentin e Republikës, Kryeministrin e Shqipërisë dhe Kryetarin e Kuvendit.

- 302 informacione për ministrinë e linjës.

- 1099 me destinacion Agjencitë e hetimit dhe të zbatimit të ligjit.

KONTROLLI I SHISH-IT

SHISH-i, për ligjshmërinë në gjithë veprimtarisë së tij, i nënshtrohet një kontrolli nga jashtë dhe nga brenda.

Kontrolli nga jashtë i SHISH-it

Kontrolli i jashtëm i SHISH-it është i trefishtë. Ai ushtrohet nga Kuvendi, nga Kryeministri dhe nga Prokurori i Përgjithshëm.

Kontrolli parlamentar

Në zbatim të ligjit nr. 8391, datë 28. 10. 1998, “Për shërbimin informativ kombëtar” të ndryshuar, veprimtaria e SHISH-it kontrollohet nga Kuvendi nëpërmjet nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar të ngritur për këtë qëllim. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Drejtori i SHISH-it raporton mbi veprimtarinë e institucionit në komisionin përkatës parlamentar, në mënyrë periodike apo sa herë e gjykon të nevojshëm ky komision.

Kontrolli i ushtruar nga Kryeministri nëpërmjet Inspektorit të Përgjithshëm

Inspektori i Përgjithshëm, i caktuar nga Kryeministri dhe në varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i SHISH-it, ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë dhe përdorimin e fondeve për veprimtari specifike operative të SHISH-it.

Kontroll nga Prokurori i Përgjithshëm

Ky kontroll ka të bëjë me format dhe metodat e punës, me qëllim që ato të jenë në përputhje të plotë me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Mbi SHISH-in ushtrojnë kontroll edhe Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Kontrolli nga brenda i SHISH-it

SHISH ka edhe mekanizma të brendshme kontrolli, të cilat përdoren në funksion të realizimit të detyrave ligjore, nga instanca më e lartë te ajo më e ulët.

Kontrolli financiar

Ky kontroll realizohet nga njësi e auditit, në zbatim të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Misioni i auditimit të brendshëm është të kontrollojë menaxhimin financiar, të japë siguri të arsyeshme për titullarin e institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetit në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kontrolle të autorizuara

Drejtori i SHISH-it ka të drejtë të autorizojë ushtrimin e kontrolleve në njësitë strukturore të SHISH-it nga persona apo njësi të autorizuar prej tij, për probleme të ndryshme që i gjykon ai si të nevojshme. Parimet e kontrollit të brendshëm janë:
Parimi i ligjshmërisë
Parimi i befasisë ose periodicitetit
Parimi i njohjes dhe objeksionit të rezultatit bazuar mbi prova dhe fakte.

Në përfundim të kontrolleve, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9357, datë 13.07.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, mund të jepen masa disiplinore me qëllim korrigjimin e veprimeve të punonjësve, në përputhje me kuadrin ligjor.

BASHKËPUNIMI BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Në përmbushje të misionit të tij, SHISH-i ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe agjenci ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit. SHISH-i bashkëpunon me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ministrinë e Financave, ILDKPKI, KLSH, Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, etj. Me urdhër të Kryeministrit, Drejtori i SHISH-it është antar i Komiteteve Ndërinstitucionale apo Komiteteve Shtetërore, kurse përfaqësues të SHISH-it janë anëtarë të grupeve ndërinstitucionale të punës për çështje të caktuara.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Globalizimi, dinamikat e zhvillimeve aktuale dhe të perspektivës, ndryshimet e vazhdueshme në mjedisin e sigurisë e kanë kthyer në domosdoshmëri koordinimin, bashkërendimin dhe bashkëpunimin mes shërbimeve partnere.

Me qëllim që të kemi një panoramë informative sa më të plotë dhe profesionale, të sfidave dhe proceseve aktuale dhe perspektive të sigurisë, SHISH-i bashkëpunon në disa nivele me shërbimet inteligjente partnere.

Për shkak të karakterit ndërkombëtar të dukurive të tilla si terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm, krimi i organizuar, zhvillimi kompleks i teknologjisë dhe komunikimit, siguria kibernetike, liria e lëvizjes, forcimi i stabilitetit rajonal, veprimtaria e shërbimeve kundërshtarë ndaj vendit tonë dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut etj., asnjë shtet nuk mund të ndërmarrë kundërmasa dhe t'i luftojë ato në mënyrë efektive, pa bashkëpunim ndërkombëtar.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, procesi i anëtarësimit në BE, siguria dhe stabiliteti rajonal, kanë rritur përgjegjësinë dhe fushat e veprimtarisë së SHISH-it. Kontributi i çmuar si antar me të drejta të plota në NATO, angazhimet dhe detyrimet në kuadër të anëtarësimit në BE janë faktorë shumë të rëndësishëm në kuadrin e integritimit euro-atlantike dhe në mbrojtjen dhe forcimin e sigurisë kombëtare.

Me qëllim parandalimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që cenojnë sigurinë kombëtare, rajonale, etj., SHISH-i mbledh, përpunon, analizon

dhe shpërndan informacion për strukturat vendimmarrëse si dhe bashkëpunon me strukturat e sigurisë dhe inteligjencës së NATO-s, BE-së dhe shteteve anëtare të tyre.

SHISH-i, si agjencia qendrore informative dhe e sigurisë, në kuadër të sigurisë kombëtare, rajonale e më gjerë, ka marrëdhënie partneriteti dy dhe shumëpalëshe me një numër të madh shërbimesh inteligjente të sigurisë dhe agjencish informative të vendeve të tjera, me të cilat bashkëpunon në kuadër të shkëmbimit të informacioneve, analizave, ekspertizës dhe në veprimtarive të përbashkëta operacionale.

Bashkëpunimi është i shtrirë kryesisht me shërbimet inteligjente të vendeve të NATO-s dhe BE-së, me shërbimet inteligjente të rajonit, si dhe shërbime të vendeve të tjera, në kuadër të interesit të ndërsjellë.

SHISH-i është kontribuues aktiv në Komitetin e Inteligjencës Civile të NATO-s (NATO/CIC) dhe Njësinë e Inteligjencës së NATO-s për Përpunimin e Informacionit (NATO/IPU).

Nivelet e bashkëpunimit të SHISH-it me shërbimet informative të vendeve të tjera miratohen nga Kryeministri.

Bashkëpunimi dypalësh zhvillohet në kuadër të takimeve të përbashkëta, marrëveshjeve dypalëshe, trajnimit të personelit, vizitave të ndërsjella, shkëmbimeve të informacionit dhe operacioneve të përbashkëta.

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe, SHISH-i ka të atashuar oficerë ndërlidhës në disa vende, të cilët kanë për detyrë forcimin e marrëdhënieve të punës me shërbimet informative të shteteve ku janë akredituar.

SHISH-i është gjithashtu antar në disa formate dhe nisma shumëpalëshe rajonale e ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe sigurisë, të tilla si "SEEIC", "MEC", "ADRIA CLUB" etj., ku diskutohet dhe shkëmbehet ekspertizë mbi sfidat dhe problematikat e sigurisë. SHISH-i merr pjesë gjithashtu në platforma të ndryshme ndërkombëtare, të cilat diskutojnë dhe trajtojnë probleme të ndryshme të sigurisë dhe inteligjencës.

Nisur nga qasja në rajon, SHISH-i ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol konstruktiv në stabilitetin rajonal dhe ka marrë në vijimësi *feedback* shumë pozitiv nga shërbimet partnere.

MITE dhe FAKTE

Me siguri, të gjithë kemi parë filma me agjentë të fshehtë dhe organizata inteligjente, me operacione të ndërlikuara dhe pajisje nga më të çuditshmet të fshehura nëpër makina, veshje, ndonjëherë edhe nën lëkurë.

Po a janë të gjitha reale? A janë të gjithë punonjësit e shërbimeve të fshehta me aftësi të jashtëzakonshme si nëpër filma, jetojnë në anonimitet sa nuk takojnë dot as familjarët apo përdorin pajisje aq të sifistikuar?

Disa filma dhe libra paraqesin një panoramë jo reale të shërbimeve të inteligjencës, një prej të cilave është edhe SHISH-i. Edhe pse këto përshkrime përdoren për zbavitje, ndonjëherë kanë ndihmuar në krijimin e miteve. Le të shohim disa të tillë.

Miti:
Duhet të jesh mbinjerëzor që të punosh në shërbimin e fshehtë.

Fakti: Shpesh agjentët e fshehtë në filma përshkruhen me fuqi jo të zakonshme, p.sh., durojnë goditje elektrike apo, me disa lëvizje karateje, shpëtojnë për pak sekonda nga rreziku. Për të punuar në SHISH, nuk duhet të kesh aftësi mbinatyrore dhe as të njohësh arte marciale. Punonjësit tanë zotërojnë aftësi gjyquese e vendim-marrëse dhe përkushtimin për t'i shërbyer ligjit dhe vendit tonë. Ne mbledhim dhe analizojmë informacione, çka përfshin edhe monitorim dhe vlerësim të gjendjes brenda dhe jashtë vendit, që nga fusha politike, te ajo ekonomike apo teknologjike.

Miti:
Duhet të përdorësh shumë pajisje sekrete.

Fakti: Në fakt, këtu ka një farë të vërtete. Filmat shfaqin lloj-lloj pajisjesh fantastike, por një oficer i SHISH-it nuk duhet t'i njohë e t'i përdorë domosdoshmërisht ato. Analistit nuk i duhet asnjë pajisje e tillë për të shkruar një raport të mirë.

Miti:
Nuk bëhesh pjesë e SHISH-it po nuk dite të paktën një gjuhë të huaj.

Fakti: Vetëm se keni parë në filma që agjentët flasin rrjedhshëm gjuhë të rralla, nuk do të thotë se ky është kusht për të fituar një pozicion në SHISH. Sigurisht, njohja e gjuhëve të huaja ka përparësitë e veta, si në çdo punë tjetër.

Miti: Nëse punon në SHISH, duhet të kufizosh komunikimin me familjen ose miqtë.

Fakti: Puna që bëjmë ne është e fshehtë, por jeta nuk ka pse të jetë e tillë. Shumica e punonjësve tanë i ka zyrat në selinë qendrore, ku përfshihen një varg i gjatë profesionesh, njësoj si në administratën shtetërore. Këtu kemi specialistë IT, juristë, ekonomistë, analistë e personel mbështetës, mes shumë të tjerave. Çdokush flet apo shoqërohet aq sa ka dëshirë me shoqërinë e familjarët e tij, çka është pjesë e jetës së përditshme të secilit.

Miti:
Nuk mund të përdorësh media sociale nëse punon në SHISH.

Fakti: E vërteta është se punonjësit e SHISH-it mund t'i përdorin mediat sociale. Vetëm se ne kemi disa rregulla dhe udhëzime për të mbrojtur jo vetëm punonjësit tanë, por edhe figurën e institucionit. Mund të zini miqësi në rrjetet sociale, të ndiqni zhvillimet e ditës dhe artin, të pëlqeni miqtë, por jo gjatë orarit të punës.

SHISH-I NË NISMA SOCIALE DHE HUMANITARE

Shërbimi Informativ i Shtetit nuk është një institucion i shkëputur nga jeta sociale e publike e vendit tonë. Ai u është përgjigjur thirrjeve dhe është përfshirë shpesh në nisma dhe veprimtari humanitare e mbështetëse, në nivel

lokal apo edhe më të gjerë. Përfituesit e mbështetjes së ofruar me bujari nga ana e SHISH-it kanë qenë individë dhe institucione publike, ndërkohë që SHISH-i nxit vullnetarizmin dhe veprimtaritë humanitare mes punon-

jësve të tij, me qëllim dhënien vlerë këtyre përpjekjeve, përmes ofrimit të kohës dhe të burimeve nga ana e tyre për njerëzit në nevojë.

Gjatë vitit 2018, spikatën dy veprimtari masive të kësaj natyre.



Në qershor, Shërbimi Informativ i Shtetit iu bashkua nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar për dhurimin vullnetar të gjakut, nën moton: “Dhurimi vullnetar i gjakut - akt human dhe qytetar”. Punonjësit e SHISH-it, nën asistencën e strukturave të Kryqit të Kuq, dhuruan gjak në ndihmë të zgjidhjes së një problemi mjaft serioz, atij të mungesës së gjakut të mjaftueshëm dhe të sigurt në spitalet tona, si dhe në shprehje të humanizmit dhe mbështetjes ndaj fëmijëve talasemikë. Drejtuesit e Shërbimit Informativ të Shtetit shprehën gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit me


Kryqin e Kuq Shqiptar dhe nisma të tjera, që ndihmojnë në ndërtimin e një dimensioni të ri social për komunitetin e inteligjencës. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Shqiptar shprehën konsiderata shumë të larta dhe falënderuan punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit për mbështetjen e programit “Dhurimi vullnetar i gjakut - akt human dhe qytetar”.

Nisma tjetër ishte ajo në mbështetje të fëmijëve jetimë me rastin e festave të fundit të vitit. Ndihma materiale ofruar këtyre fëmijëve në institucionet publike shërben sadopak që kjo bashkësi të përmbushë potencialin e saj dhe të ndjehet pjesë e integruar e një brezi të arsimuar dhe të vlerësuar, i aftë të kontribuojë në përparimin e vendit

dhe zhvillimin shoqëror të tij.

Punonjësit tanë mblodhën kontribute për fëmijët jetimë të shtëpisë së fëmijës “Hana dhe Rozafa” në Tiranë.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror falënderoi institucionin tonë përmes një letre të posaçme, duke na siguruar se kontributi ynë do të ndihmojë në krijimin e një të ardhmeje më të mirë për këta fëmijë.



NJË MUZE NË SHISH

Duke nisur nga dhjetori 2018, mjediset e Shërbimit Informativ të Shtetit përfshijnë edhe një mini-muze, të përruar me rastin e 106 vjetorit të krijimit të këtij institucioni.

Muzeu, i ndërtuar në një sallë rrethore, formë e cila simbolizon qarkullimin e informacionit, duke i bërë jehonë edhe logos zyrtare të SHISH-it, ka për qëllim të ekspozojë disa dhjetëvjeçarë veprimtari dhe pajisje, por edhe të frymëzojë dhe edukojë punonjësit e rinj apo vizitorët lidhur me këtë hallkë të rëndësishme

të veprimtarisë së shtetit shqiptar.

Në muzeun e vogël janë ekspozuar dokumente të paklasifikuara dhe materiale historike, përgjithësisht të 50-60 viteve të shkuara, të cilat të ndihmojnë edhe për të bërë më mirë dallimin në metoda dhe në pajisje pune mes periudhave të ndryshme.

Edhe pse modest, SHISH-i shpreson që ky mini-muze, duke u pasuruar edhe më tej, të jetë njëherësh pjesë e asetit kulturor të shtetit tonë.





FESTA E VITIT TË RI PËR FËMIJËT

Mes punonjësve të SHISH-it, ka edhe shumë prindër të rinj, prandaj vendosëm të organizonim një festë për Vitin e Ri në dhjetor me fëmijët. Qëllimi ishte jo vetëm të kënaqeshin me dhurata fëmijët e punonjësve, por ta sillnim festën brenda institucionit, që fëmijët të gëzonin dhe të shihnin ku punojnë prindërit e tyre.

Për ta sjellë sa më pranë tyre atmosferën e festës, ftuam Borëbardhën dhe një kloun, sepse asnjë festë e Vitit të Ri nuk quhet e plotë pa pak humor. Koha kaloi hareshëm për fëmijët dhe të rriturit, me shumë lojëra dhe truke nga aktorët profesionistë.

Në fund, festa jonë e Vitit të Ri ishte sukses i madh, sepse të gjithë u kënaqën.



PËRGJEGJSHMËRIA PËRA PUBLIKUT

Publiku i gjerë gjithnjë ka shfaqur interes të veçantë për tema të ndërlidhura me veprimtarinë e Shërbimit Informativ të Shtetit. Publiku kërkon të dijë më tepër për veprimtarinë e SHISH-it dhe ne njëherësh duam të rrisim ndërgjegjësimin publik për përgjegjësitë dhe pushtetin tonë. Por e drejta kushtetuese e informimit nuk gjen zbatim për informacionin e klasifikuar. Për këtë arsye, marrëdhëniet e SHISH-it me publikun përbëjnë një sfidë më vete. Kjo vjen sepse, nga njëra anë, SHISH-i duhet të ruajë konfidentalitetin e veprimtarive dhe operacioneve të tij dhe, nga ana tjetër, duhet të plotësojë nevojën e publikut për informacion autentik mbi sfidat e sigurisë.

SHISH-i përpiqet të jetë sa më afër publikut edhe duke marrë pjesë në angazhime të organizatave të shoqërisë civile, forume shkencore e seminare universitare. Por një nga mënyrat për ta familiarizuar sa më tepër publikun me punën tonë është ky raport publik, i cili përmban informacion të paklasifikuar për punën e SHISH-it, për gjendjen në Shqipëri dhe në rajon.

Ky është raporti i parë publik, i cili shpresojmë të ngjallë interes të gjerë, ndërsa komentet nga publiku i përgjithshëm dhe ai ekspert janë të mirëpritura.

Është i ngjashëm me raportet që pro-

dhojnë rregullisht shërbimet e fshehta në vendet demokratike.

SHISH-i po ashtu ka një adresë publike emaili dhe një faqe zyrtare interneti, e cila mund të konsultohet nga të gjithë. Puna e Shërbimit Informativ të Shtetit është vlerësuar

edhe nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë, përmes akordimit të Dekoratës së Artë të Shqiponjës. Dekorata është akorduar me këtë motivacion: “Për punën, përpjekjet, sakrificat dhe arritjet e vazhdueshme 25-vjeçare të punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit në realizimin me guxim, qëndrueshmëri, besnikëri, përkushtim e vetëmohim të detyrave të tyre ligjore; për forcimin e sigurisë së shtetit e qytetarëve të tij, si dhe për garantimin e suksesit të zhvillimit ekonomik, shoqëror, liberal e demokratik të vendit”.



LISTA E SHKURTESAVE

AIDSSH - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit
AISM - Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
BE - Bashkimi Evropian
CSP - Certifikatë e Sigurimit të Personelit
DSIK - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
ISIS - DAESH - Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
IT&T - Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimit
KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPSK - Komiteti i Politikave të Sigurimit Kombëtar
KS - Këshilli i Sigurimit
LHT - Luftëtar i Huaj Terrorist
MEC - Konferenca e Evropës Qendrore
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NATO / CIC - Komiteti i Inteligjencës Civile të NATO-s
NATO / IPU - Njësia e Inteligjencës së NATO-s për Përpunimin e Informacionit
OJQ - Organizatë Joqeveritare
OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
RSH - Republika e Shqipërisë
SEEIC - Konferenca e Inteligjencës së Evropës Juglindore
SSK - Strategjia e Sigurisë Kombëtare
SHIK - Shërbimi Informativ Kombëtar
SHISH - Shërbimi Informativ i Shtetit
TFQ - Task Forcë Qendrore
VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave

Ky dokument është pronësi e SHISH-it. Botohet me qëllim informimin e publikut të përgjithshëm mbi veprimtarinë e SHISH-it, mbi sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballen vendi. Dokumenti është publik, gjendet edhe në format elektronik në adresën tonë www.shish.gov.al. Teksti dhe figurat mund të përdoren për arsye studimore e informuese, duke cituar detyrësisht burimin.

Kontakt:

Tel: +355 69 4138387

Email: transparenca@shish.gov.alAdresa postare: Rruga "Kongresi i Manastirit", Tiranë, Shqipëri
www.shish.gov.al

DREJTORËT E SHËRBIMIT INFORMATIV



Visho Ajazi Lika
09.08.2012 - 30.10.2017



Bahri Shaqiri
27.01.2005 - 09.08.2012



Kujtim Hysenaj
18.11.2002 - 27.01.2005



Petrit Myftari
07.08.2002 - 18.11.2002 (i komanduar)



Fatos Klosi
21.08.1997 - 07.08.2002



Arben Karkini
29.05.1997 - 21.08.1997



Astrit Kodra
09.04.1997 - 29.05.1997 (i komanduar)



Bashkim Gazidede
29.06.1992 - 09.04.1997



Irakli Koçollari
01.08.1991 - 29.06.1992

Ky është raporti i parë publik i Shërbimit Informativ të Shtetit. Ai përmban informacion të paklasifikuar për punën e SHISH-it, për gjendjen në Shqipëri dhe në rajon. Botohet me qëllim informimin e publikut të përgjithshëm mbi veprimtarinë e SHISH-it, sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballet vendi. Është i ngjashëm me raportet që prodhojnë rregullisht shërbimet e fshehta në vendet demokratike. Ky dokument është pronësi e SHISH-it. Dokumenti është publik, gjendet edhe në format elektronik në adresën www.shish.gov.al. Teksti dhe figurat mund të përdoren për arsye studimore e informuese, duke cituar detyrimisht burimin. Komentet nga publiku i përgjithshëm dhe ai ekspert janë të mirëpritura.

ISBN 978-1-78280-808-4



9

781782

808084